



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:014600

Datë: 17.05.2024

Numri i dokumentit: 05703562

P.nr.1332/14

NË ËMER TË POPULLIT

GJYKATA THËMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtaren e vetme gjykuese Hakile Ilazi, me zyrtarin ligjor Ymri Ibrahim, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.B., për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 pika 1.1 të KPRK-ës, dhe të akuzuarit F.H. për shkak të veprës penale blerje, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-ës, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj– Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.628-6/14 e datës 08.12.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik me datë 18.04.2024, në praninë e prokurorit të shtetit Mimoza Sylja Hyseni, të dëmtuarit N.K. dhe të akuzuarit B.B. me mbrojtësen me autorizim Av. Zejnie Bega, me datë 18.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 08.05.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I.

I akuzuari:

B.B., i lindur me datën ... në Ferizaj, nga i ati X., e ëma B., e gjinisë T., me vendbanim në rrugën “E...” nr...., Komuna Ferizaj, ka të kryer shkollën e mesme të bujqësisë, i martuar, baba i dy fëmijëve, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal 1.., ndodhet në vuatje të dënimit për vepra të tjera penale në Burgun e Dubravës.

Në kuptim të nenit 363 par. 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-ës.

LIROHET NGA AKUZA

Sepse:

Me dt..., ne interval kohor prej orës 12 deri ora 07:00, në shitoren “G.” në fshatin N., komuna Ferizaj, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetit t’i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, me forcë ka hapur derën e shitores “G.” pronë e të dëmtuarit N.K. dhe nga aty ka marrë një telefon “N.”, cigare te llojeve të ndryshme (west, mallboro, licky strike, ronhill, vinston, boos prestige dhe 57), katër mbushje të kompanisë “V..” dhe para metalike, vlera e përgjithshme e dëmit të shkaktuar sipas të dëmtuarës është 312€.-

meqë nuk është provuar se ka kryer veprën penale vjedhja e rëndë nga nen 327 par.1 pika1.1 të KPRK-së.

Pasi që i dëmtuari N.K. me vendbanim në fshatin ..., Komuna Ferizaj ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike, gjykata të njëjtin nuk e ka udhëzuar në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës gjyqësore bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

II.

Për të akuzuarin

F.H., i lindur me datën .., në S., nga i ati S.e ëma X., e gjinisë B., me vendbanim në rrugën “V.” (Vizioni 1), Komuna Ferizaj, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion mashinbravarë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 362 par. 1 nën par 1.3 të KPPRK-ës,

REFUZHET AKUZA

Me dt. 29.07.2013, në Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit t’i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm ka pranuar- blerë mallra të vjedhura nga i

pandehuri Besart dhe atë: telefonin “Nokia”, të cilin e ka blerë me vlerë prej 10€, e për të cilin i pandehuri ka mundur ta dijë se është përfituar me anë të veprës penale të vjedhje.-

me të cilën do të kryente veprën penale blerje, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPK-së.

Pasi që gjykata në bazë të vlerësimit të shkresave ka konstatuar se kemi të bëjmë me parashkrim absolut të kësaj vepre penale.

Pasi që i dëmtuari N.K. me vendbanim në fshatin ..., Komuna Ferizaj ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike, gjykata të njëjtin nuk e ka udhëzuar në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës gjyqësore bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Historiku procedural

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngritur aktakuzë PP/II.nr.628-6/14 të datës 08.12.2014, me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin B.B. për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 327 par.1 pika 1.1 të KPRK-ës dhe të akuzuarin F.H., për shkak të veprës penale blerje, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPRK-së,

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 20.06.2018, si dhe shqyrtimin gjyqësor me datë 18.04.2024, në të cilin të pranishëm ishin prokurori i shtetit Mimoza Sylja Hyseni, i dëmtuari N.K., i akuzuari B.B. dhe mbrojtësa e tij me autorizim Av Zejnie Bega.

Mbrojtja e të akuzuarit

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtarja e vetme gjykuese e ka udhëzuar dhe njoftuar të akuzuarin për të drejtat dhe detyrimet e tij në kuptim të nenit 319 paragrafi 1 dhe 2 të KPPK-së.

Pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me nenin 321 par.1 të KPPK-së, i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e tij si në shqyrtimin fillestar ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë dhe nuk e ndien veten fajtor për veprën penale që i është vënë në barrë nga ana e prokurorisë, ndërsa në mbrojtjen e tij ka deklaruar se për këtë rast ka dhënë deklaratë si në polici ashtu dhe në prokurori dhe nuk e konsideron veten fajtor për veprën penale që akuzohet, duke e mohuar që telefoni është gjetur tek ai, por tek një person tjetër, emri i të cilit nuk i kujtohet pasi që ka kaluar një kohë e gjatë.

Tutje i njëjti deklaron se në atë kohë e ka pasur në pronësi një telefon, modeli dhe ngjyra e të cilit nuk i kujtohet, pasi që të gjithë në shtëpi kanë pasur telefona, dhe që këtë telefon deklaron se e ka blerë tek posta afër xhamisë ku shesin telefona dhe e ka mbajtur në pronësi për 6-7 muaj dhe pasi që të njëjtit i ka rënë vlera i'a ka shitur një personi të cilin nuk e njeh dhe nuk i kujtohet pasi që ka kaluar një kohë e gjatë.

Provat dhe dëshmitë e prezantuara në shqyrtim gjyqësor

Pasi që i akuzuari, nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që e ngarkon aktakuza. Gjyqtarja e vetme gjykuese ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 325 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, gjykata gjeti se nuk u provua se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza.

Gjendjen e këtyre faktike gjykata e ka vërtetuar nga prezantimi i provave në shqyrtimin e mbajtur gjyqësor dhe atë:

- Pjesërisht nga mbrojtja e vetë të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor 18.04.2024;
- Nga dëshmia e dëshmitarit- të dëmtuarit N.K. dhënë në shqyrtim gjyqësor 18.04.2024;

Nga provat materiale dhe atë:

- deklartat e të akuzuarit e dhënë në Prokurori me datën 21.10.2014 dhe në polici me datën 29.09.2013,

- deklarata e të dëmtuarit e datës 21.10.2014, e dhënë në Prokurori dhe në polici me datën 28.07.2013,

-raporti i oficerit i datës 25.07.2013 si dhe

- njoftimi i postës në mënyrë elektronike se telefoni është gjetur tek i akuzuari.

Gjykata me qëllim të vërtetimit sa më të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje penale në cilësinë e të dëshmitarit ka dëgjuar edhe të dëmtuarin N.K. i cili në dëshminë e tij në shqyrtim gjyqësor të datës 18.04.2024 ka deklaruar se të akuzuarin nuk e njeh dhe se është hera e dytë që e takon në seancën gjyqësore pasi herën e parë e kishte parë në senacën fillestare të datës 20.06.2018, duke shtuar se i kujtohet se në ditën kritike për të cilën bëhet fjalë, ka qenë muaji i “Ramazanit” dhe kur është zgjuar në mëngjes dhe ka shkuar te lokali që ka pasur një market i cili është quajtur “G..”, ku aty ka shkuar për ta hapur dhe filluar punën ku me të shkuar aty ka vrejtur se rrethojat e hekurit të lokalit kanë qenë të prera dhe dritarja ka qenë e thyer, i njëjti thekson se në lokal ka qenë telefoni i vëllaut B.K. i markës “Nokia”, dhe disa gjëra dhe monedha me vlerë prej 400 eurove, e po ashtu ka shtuar se kanë munguar cigare të llojeve të ndryshme dhe mbushje të telefonit.

Më tutje në deklarimin e tij i njëjti ka potencuar se të akuzuarin nuk e njeh, e ka parë vetëm në seancat e caktuara nga gjykata, e po ashtu te lokali nuk ka pasur kamera, e as lokal tjetër afër tij, lokalin i njëjti e ka pasur në shfrytëzim me qera, pasi që lokalin në fjalë në pronësi e ka pasur personi i quajtur A.S., i cili ka jetuar më larg nga vendi ku ka ndodhur ngjarja, të cilin e kanë pyetur për thyerjen e lokalit, por i njëjti nuk ka pasur njohuri.

I njëjti ka shtuar se është njoftuar për gjetjen e telefonin nga policia, por që nuk i kan treguar se ku e kanë gjetur telefonin, e as nuk e kanë kthyer si dhe nuk e kanë njoftuar për arsyet e mos kthimit të tij.

Pas paraqitjes së provave, konform nenit 350 par.1 të KPPK-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor dhe shqyrtimet e mëhershme gjyqësore si dhe provat materiale deklartat e të akuzuarit e dhënë në Prokurori me datën 21.10.2014 dhe në polici me datën 29.09.2013, deklarata e të dëmtuarit e datës 21.10.2014, e dhënë në Prokurori dhe në polici me datën 28.07.2013, deklarata e të dëmtuarit B.K. e dhënë në polici me datën 25.07.2013, raporti i oficerit i datës 25.07.2013 si dhe njoftimi i postës në mënyrë elektronike se telefoni është gjetur tek i akuzuari, si dhe pas dëgjimit të të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit N.K., e po ashtu pjesërisht edhe nga mbrojtja e të akuzuarit u vërtetua gjendja faktike si në aktakuzë, andaj e njëjta i propozon gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe të i shqiptojë një sanksion penal të paraparë me ligj.

Tutje e njëjta shton se sa i përketë majtes dhe shqiptimit të dënimit gjykata të ketë parasysh edhe rrethanat, si rrethanë rënduese të merr shkallën e lartë të dashjes nga ana e të akuzuarit si dhe e njëjta i propozon gjykatës që përmes sistemit SMIL të evidentoj të kaluarën kriminale të të akuzuarit pasi që dyshohet se ka edhe vepra të tjera penale të natyrës së njëjtë, ndërsa sa i përket rrethanave lehtësuese e njëjta deklaron se për këtë rast nuk u gjetën.

I dëmtuari N.K. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale duke shtuar se nuk e ka parë se kush e ka thyer lokain, e po ashtu ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Mbrojtësja e të akuzuarit Av. Zejnie Bega në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se i mbrojturi i saj ta ketë kryer këtë vepër penale për të cilën akuzohet dhe se gjendja e përshkuar si në dispozitivin e aktakuzës në elementete qënesore të saj nuk vërtetohet me asnjë provë të administruar, përfshirë edhe dëgjimin e dëmtuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku i njëjti ka deklaruar se personin e akuzuar nuk e ka parë asnjëherë, përjashtimisht vetëm në gjykatë derisa është zhvilluar procedura penale ndaj tij. Andaj e njëjta i propozon gjykatës që për të akuzuarin B.B. të merr aktgjykim lirues në mungesë të proave.

I akuzuari B.B. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtëse së tij dhe kërkon nga gjykata që ta lirojë nga akuza.

Vlerësimi i dëshmisë provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Gjykata në këtë çështje penale me një vëmendje dhe kujdes të shtuar ka analizuar dhe vlerësuar dëshminë e dëshmitarit si dhe të gjitha provat materiale veç e veç dhe të ndërlidhura në mes vete, mirëpo edhe pas këtij vlerësimi gjykata gjeti se me asnjërën prej këtyre provave nuk provohet se i akuzuari e ka kryer veprën penale që i është vënë në barrë nga ana e prokurorisë.

Fillimisht gjykata vlerëson si të pakontestueshme dhe të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Se në ditën kritike të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës të dëmtuarit në lokalit të tij i ish marrë sendet personale dhe marteriale si: një telefon “Nokia”, cigare të llojeve të ndryshme (west, mallboro, licky strike, ronhill, vinston, boos prestige dhe 57), katër mbushje të kompanisë “Vala” dhe para metalike.

Për gjykatën ishte kontestuese vërtetimi i faktit se i akuzuari ditën kritike kur ka ndodhur ngjarja, a kishte depërtuar në lokalit të dëmtuarit dhe a i kishte marrë sendet e lartëcekura me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror, ky fakt për gjykatën nuk arriti të vërtetohet gjatë shqyrtimit gjyqësor me asnjë provë të vetme qoftë provë personale apo materiale.

Gjykata sa i përket rastit konkret vlerëson se në deklarin e të dëmtuarit dhe në rrjedhën e tregimit të tij në prokurori edhe në shqyrtim gjyqësor i njëjti në asnjë moment nuk e ka inkrimimnuar të akuzuarin si kryes të veprës penale, sepse i njëjti kishte deklaturar se pasi që kishte shkuar tek lokalit për ta hapur dhe vazhduar punën, kishte parë që rrethojat e hekurta të lokalit kishin qenë të prera dhe dritarja kishte qenë e thyer dhe kishte vrejtur se brenda në lokalit mungonin disa gjëra duke përfshirë këtu telefonin e vllaut të markës “Nokia”, cigare të llojeve të ndryshme dhe mbushje telefoni, por që i njëjti nuk e ka parë dhe nuk ndonjë dyshim se kush mund ta ketë thyer lokalit, andaj të njëjtit i shpreh besimin, mirëpo nga kjo dëshmi gjykatës në asnjë mënyrë nuk i vërtetohet se i akuzuari kishte kryer këtë vepër penale, për faktin se i dëmtuari në asnjë pjesë të dëshmisë së tij nuk e ka përmendur se i akuzuari e ka kryer këtë vepër penale

madje ka shtuar se të akuzuarin nuk e njeh, nuk e ka parë asnjëherë përveq në seancat gjyqësore dhe se nuk i bashkangjitet ndjekes penale.

Gjithashtu, gjykata me rastin e vlerësimit të dëshmisë së të dëmtuarit gjeti se kjo dëshmi është në përputhje të plotë me provat materiale të administruara në këtë çështje penale dhe të njëjtës i shpreh besimin e plotë, pa harruar të përmendet fakti se i dëmtuari nuk ka mundur të i provoj gjykatës se i akuzuari e ka kryer këtë veprë penale si në dispozitivin e aktakuzës.

Gjykata në këtë çështje penale ka administruar si provë materiale edhe njoftimin e postës në mënyrë elektronike se telefoni është gjetur tek i akuzuari, mirëpo edhe për gjykatën nuk është kontestuese se telefoni e ka pasur i akuzuari, madje ky fakt nuk është mohuar as nga i akuzuari. Kjo provë materiale gjykatës nuk i provon në asnjë mënyrë, se ky telefon është vjedhur nga i akuzuari, madje për këtë i akuzuari ka deklaruar se telefoni të cilit i referohet akuza, e ka blerë tek posta afër xhamisë nga një person emri i të cilit nuk i kujtohet, pasi që ka kaluar një kohë e gjatë.

Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit

Gjatë vlerësimit të të gjitha provave, gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit në fazën paraprake por edhe në shqyrtimin kryesor e cila është vlerësuar si një mbrojtje e thjeshtë, duke u munduar që të shpjegojë tërë kronologjinë e ngjarjes dhe duke u përqendruar në atë se në asnjë mënyrë nuk e thyer lokalin dhe marrë telefonin, e duke e mohuar kategorikisht kryerjen e veprës penale nga fakti se ai e ka blerë këtë telefon nga një person tek posta afër xhamisë dhe e ka shitur tek një person tjetër i panjohur, pasi që i kishte rënë vlera.

Gjykata nga mbrojtja e të akuzuarit nuk ka arritur të vërtetojë se i akuzuari, a ka qenë i implikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në kryerjen e kësaj veprë penale, kur kihet parasysh edhe faktin se përfshirja e të akuzuarit në kryerjen e kësaj veprë penale nuk mund të vërtetohet me asnjë provë tjetër reale, bindëse dhe të pakontestueshme.

Gjykata ka analizuar edhe dispozitën e nenit 327 të KPRK-së, ku përkufizohet:

“Kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1. i nenit 325 të këtij Kodi, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet.”

Për të vazhduar se *“vepra është kryer duke thyer, kaluar apo depërtuar me forcë në veturat e mbyllura, ndërtesat, dhomat, arkat, sanduqet apo hapësirat tjera të mbyllura ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme”*.

Por, gjithsesi është e padiskutueshme se dispozita e lartcekur, inkriminon veprimet në formë të drejtpërdrejt apo alternative, e që gjykata në rastin konkret nuk ka mundur të vërteton se veprimet e tilla janë ndërmarrë nga i akuzuari, përkatësisht faktin se a është përdorur forca apo dhuna me rastin e depërtimit në lokalit të dëmtuarit dhe kryerjen e kësaj vepre penale.

Në kontest të kësaj edhe nga përshkrimi i dispozitivit të aktakuzës, nuk është vërtetuar përshkrimi i veprimeve të të akuzuarit ndaj të dëmtuarit, e të cilat veprime nuk kanë mundur të provohen as me dëgjimin e të dëmtuarit dhe mbrojtjes së të akuzuarit, por as me provat materiale në këtë çështje penale, e të cilat do t'i paraqesim në vijim:

- në fillim ...” me dt.25.2013, ne interval kohor prej orës 12 deri ora 07:00, në shitoren “G.” në fshatin ..., komuna Ferizaj, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme e që vetit t'i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, me forcë ka hapur derën e shitores “G.” pronë e të dëmtuarit N.K., një pretendim i tillë në aktakuzë, respektivisht fakti se kjo vepër penale është kryer nga i akuzuari në datën dhe vendin e përmendur më lartë nuk mund të vërtetohej as në dëshminë e dëshmitarit-dëmtuarit, e as me ndonjë provë tjetër materiale të prezentuar nga ana e prokurorisë, nuk është arritur të provohet se kjo vepër penale është kryer nga i akuzuari në datën dhe vendin që pretendohet në aktakuzë.

-për të vazhduar *“...nga aty ka marrë një telefon “Nokia”, cigare te llojeve të ndryshme (west, mallboro, licky strike, ronhill, vinston, boos prestige dhe 57), katër mbushje të kompanisë “V.” dhe para metalike, vlera e përgjithshme e dëmit të shkaktuar sipas të dëmtuarës është 312€”, një pretendim i tillë i prokurorisë ishte i pabazë për faktin se as për gjykatën nuk është kontestuese që këto gjëra materiale kanë munguar tek lokali i të dëmtuarit, mirëpo gjykatës nuk i është provuar në asnjë mënyrë se ka qenë i akuzuari ai person i cili ka marrë këto gjëra nga lokali i të dëmtuarit.*

Vlerësimi i fjalës përfundimtare të prokurorit të shtetit

Gjykata me një vëmendje dhe kujdes të shtuar e ka analizuar dhe vlerësuar edhe fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit.

Pretendimin e prokurorit të shtetit se fakti se kryerja e kësaj vepre penale është vërtetuar pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarit gjykata e vlerëson si të pabazë, kjo për faktin se i akuzuari në vazhdimësi e ka mohuar kryerjen e kësaj vepre penale dhe se gjykata në asnjë pjesë të mbrojtjes së tij, por edhe në asnjë provë tjetër materiale nuk gjeti se i akuzuari e ka pranuar kryerjen e kësaj vepre penale.

Si të pabazë gjykata e vlerësoi edhe pretendimin e prokurorisë se kryerja e kësaj vepre penale nga ana e të akuzuarit është vërtetuar edhe me dëshminë e të dëmtuarit, për faktin se me rastin e vlerësimit të dëshmisë së të dëmtuarit, i dëmtuari në asnjë pjesë të dëshmisë së tij nuk e ka inkriminuar të akuzuarin si kryerës të kësaj vepre penale, madje thekson faktin se të akuzuarin e ka parë vetëm në senacat gjyqësore.

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPRK-së, parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të akuzuarit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Për më tepër është e pa diskutueshme çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohej si e kundërt, kjo nga fakti se njëri prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPRK-së, dhe e garantuar me nenin 6.2 të KEDLNJ, në të cilën gjykata detyrohet që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, si ato kundër të akuzuarit dhe ato në favor të tij dhe t'i mundësoj të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të akuzuarit.

Prandaj duke u bazuar në të gjitha ato që u thanë më lartë, gjykata erdhi në përfundimin se nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe të njëjtin ka vendosur që ta lirojë nga akuza ashtu siç është vendosur edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përketë pjesës II të këtij aktgjykimi (pjesës refuzuese)

Sipas dispozitivi rezulton se vepra penale pretendohet te jetë kryer në vitin 2013 dhe për veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale për të cilën është ngarkuar i akuzuari me Kodin Penal të Kosovës, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur është ngritur aktakuza sipas nenit 345 par. 2 të KPK-së parashihet dënimi me burgim deri në 1 (një) vit.

Neni 106 i Kodit Penal të Kosovës rregullon parashkrimin e ndjekjes penale, ku sipas paragrafit 1 nën par. 1.6 të kësaj dispozite është paraparë që ndjekja penale për veprat penale të dënueshme deri në 1 (një) vit nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 2 (dy) vite nga kryerja e veprës penale, (parashkrimi relativ i ndjekjes penale), ndërsa në bazë të nenit 107 par.1 dhe 8 të KPK-së, është paraparë se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (parashkrimi absolut i ndjekjes penale), pra nga kryerja e veprës penale e deri në datën e këtij vendimi rezulton të kenë kaluar mbi 10 (dhjetë) vite nga koha e kryerjes së veprës penale dhe rrjedhimisht në këtë çështje penale ka ndodhur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Kërkesa pasurore juridike si dhe shpenzimet procedurale

Vendimet lidhur me pjesën e I të këtij aktgjykimi

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë konform dispozitave të nenit 453 par.1 të KPPK-së, pasi që i akuzuari është liruar nga akuza, shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, ndërsa

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marrë në bazë të nenit 460 par.1 si dhe nenit 462, pasi që i dëmtuari ka heq dorë nga kërkesa pasurore juridike,

Vendimet lidhur me pjesën e II të këtij aktgjykimi

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë konform dispozitave të nenit 453 par.1 të KPPK-së, pasi që për të akuzuari është refuzuar akuza, pasi që ka arritur parashkrim absolut shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, ndërsa

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marrë në bazë të nenit 460 par. 1 si dhe nenit 462, pasi që i dëmtuari ka heq dorë nga kërkesa pasurore juridike

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm Penal,

P.nr.1332/14 i datës 08.05.2024

Zyrtari ligjor

Ymri Ibrahim

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Hakile Ilazi

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.